



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANEL NO: 1

NR. I VENDIMIT.: KPCC/D/R/191/2013
DATA E VENDIMIT: 13/02/2013

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në secilën prej 44 (dyzetekatër) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë.

(2) Në secilën prej 28 (njëzetët) kërkesave të identifikuara në pjesët C dhe D të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet; dhe.

(3) Në kërkesat me nr. 07108, 07112, 10139, 31711 dhe 31719, të referuara në pjesët B dhe D të listës së bashkangjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesa të hidhet poshtë kur paraqitësi i kërkesës kërkon kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposeditim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposeditim në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-

ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e tridhjetetretë nga 11 deri 13 shkurt 2013 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 169 kërkesa për pronë banesore në seancën e tridhjetetretë nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së (“Sekretaria Ekzekutive”), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Dy kërkesa të cilat i ishin paraqitur Komisionit, u tërhoqën nga Sekretaria Ekzekutive gjatë seancës. Përveç kësaj, Komisioni vendosi dy kërkesa të cilat ishin pezulluar më parë në pritje të seancës dëgjimore. Gjithsej 169 kërkesa për pronë banesore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, me përjashtim të kërkesave me nr. 00809, 00810, 00837, 01110, 01206, 01209, 08628, 08750, 11718, 16516, 26828 dhe 53034 paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë. Që të gjitha kanë të bëjnë me pronat banesore, përfshirë tokën e bashkuar. Në kërkesat me nr. 00809, 00810, 00837, 01110, 01206, 01209, 08628, 08750, 11718, 16516, 26828 dhe 53034 paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

8. Ky vendim përfshin 72 kërkesa për pronë banesore të cilat janë të shënuara në pjesët A, B, C dhe D të listës së bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej 97 kërkesave për pronë banesore përfshihen në vendimet KPCC/D/R/189/2013 dhe KPCC/D/R/190/2013.

9. Të 37 kërkesat e shënuara në pjesët B dhe D të listës së bashkangjitur janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose një palë që ka shprehur interes ligjor në këto prona (“pala përgjegjëse”) e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t’u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

10. Të 35 kërkesat e shënuara në pjesët A dhe C të listës së bashkangjitur janë jokontestuese në kuptimin se asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Vendimet e marra për kërkesat që janë notifikuar pasaktësisht janë shfuqizuar nga Komisioni për të siguruar notifikimin e saktë të pronave dhe për t'u ofruar personave që mund të kenë interes ligjor në pronë me mundësinë për t'i dhënë përgjigje kërkesës sipas nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK/REG-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Këto kërkesa janë identifikuar në kolonat përkatëse të listës së bashkangjitur këtij vendimi. Sekretaria Ekzekutive ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme duke përfshirë notifikimin fizik të pronës, dhe/ose me anë të notifikimit të pronës përmes publikimit në gazeta zyrtare dhe gazeta, përmes autoriteteve vendore komunale, gjykatave vendore, udhëheqësve vendorë në fshat dhe institucioneve përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informacionet e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

B. Kërkesa të hedhura poshtë.

11. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

12. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

13. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit.)

14. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj për pronën e kërkuar.

15. Ndonëse Komisioni ka pikëpamjen se humbja e posedimit që ka ndodhur përtej periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të konsiderohet që ndërlidhet drejtpërsëdrejti me, apo që është pasojë e konfliktit, varësisht nga rrethanat e rastit, ai duhet të konstatojë se ka disa dëshmi që tregojnë se humbja e posedimit përfshin rrethanat që janë pasojë e konfliktit.

I. Tjetërsimi vullnetar apo aftësia për të ushtruar të drejtat pronësore

16. Në 21 kërkesat e identifikuara në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, kërkesat janë paraqitur nga paraqitësi përkatës i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar sipas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore. Në të gjitha këto kërkesa, paraqitësit e kërkesave kanë pretenduar fillimisht se ata ose familjet e tyre kanë humbur posedimin e pronave të kërkuara për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999. Megjithatë, paraqitësit e kërkesave me vonë informuan Sekretarinë Ekzekutive se ata ose familjet e tyre, sipas rastit, i kanë shitur pronat e kërkuara tek një palë e tretë pas konfliktit, bazuar në kontratën e vlefshme të shitjes.

17. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se në këto kërkesa paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore sipas rastit, nuk e kanë humbur posedimin për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999, por si rezultat i transaksionit vullnetar të shitjes e cila tregon se këta paraqitës të kërkesës ose mbajtës të së drejtës pronësore, sipas rastit, kanë tani mundësinë për të ushtruar të drejtat pronësore. Rrjedhimisht kërkesat bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

1. Kërkesat nr. 36701 dhe 36702

18. Në kërkesat nr. 36701 dhe 36702, të referuara në pjesën B të listës së bashkangjitur, kërkesat janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës, Zoran Bozidar Kostic, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij Bozhidar Kostic. Në kërkesat nr. 07108 dhe 07112, paraqitësi i kërkesës, Dara Kostic, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të saj të ndjerë, Lenka Kostic kërkon për të njëjtat prona. Të dy paraqitësit e kërkesës kanë paraqitur një kontratë blerje të verifikuar pozitivisht të vitit 1958 të lidhur mes mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore në kërkesat nr. 07108 dhe 07112, Lenka Kostic dhe një palë të tretë në bazë të të cilës mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në

kërkesat nr. 07108 dhe 07112 ka përfituar pronësinë për pronat e kërkuara. Paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 36701 dhe 36702, Zoran Bozidar Kostic në mbështetje të kërkesave, ka paraqitur me tej një vendim trashëgimie të vitit 2006, në bazë të të cilit mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në kërkesat nr. 36701 dhe 36702, Bozidar Kostic ka trashëguar pronat e kërkuara nga nëna e tij e cila është mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në kërkesat nr. 07108 dhe 07112. Mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në kërkesat nr. 07108 dhe 07112 ka vdekur në vitin 1996. Vendimi i trashëgimie është verifikuar si i vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

19. Pala përgjegjëse kërkon të drejta ligjore për pronat e kërkuara duke pohuar se ai i ka blerë ato nga mbajtësi i së drejtës pronësore për kërkesat nr. 36701 dhe 36702. Në mbështetje të pohimit të tij, pala përgjegjëse ka paraqitur një kontratë blerje të lidhur në vitin 2006, mes palës përgjegjëse si blerës dhe mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore të kërkesave nr. 36701 dhe 36702 si shitës i pronave të kërkuara, e përfaqësuar nga një palë e tretë të cilës i është dhënë autorizimi nga mbajtësi i së drejtës pronësore për kërkesat nr. 36701 dhe 36702. Kontrata e blerjes si edhe autorizimi të paraqitur nga pala përgjegjëse janë verifikuar si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive.

20. Paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 36701 dhe 36702 si edhe paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 07108 dhe 07112 e mohon faktin se pronat e kërkuara i janë shitur palës përgjegjëse duke deklaruar se autorizimi është falsifikuar. Megjithatë, ata dështuan të paraqesin dëshmi në mbështetje të kësaj mbrojtje të cilat do të kundërshtonin vlefshmërinë e kontratës së blerjes dhe të autorizimit respektivisht, të cilat ashtu si u theksua më sipër janë verifikuar si të vërteta.

21. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se mbajtësi i së drejtës pronësore nuk e ka humbur posedimin për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999, por si rezultat i shitjes që ka ndodhur pas konfliktit. Rrjedhimisht, kërkesat nr. 36701 dhe 36702 bien jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

2. Kërkesa nr. 10139

22. Kërkesa nr. 10139, e referuar në pjesën B të listës së bashkangjitur është depozituar nga paraqitësi i kërkesës, Zoran Denic në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjarë të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij, Slavoljub Denic. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur *inter alia* një vendim trashëgimie të verifikuar pozitivisht të vitit 2001, në bazë të të cilit mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore ka trashëguar pronën e kërkuar nga nëna e tij e ndjerë. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex-officio* certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2005, e cila e tregon mbajtësin e pretenduar të së drejtës pronësore si pronar të pronës së kërkuar. Më tej, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një kontratë dhurimi të lidhur mes paraqitësit të kërkesës dhe mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore me anë të secilës, mbajtësi i së drejtës pronësore pretendon se ia ka dhënë pronën e kërkuar paraqitësit të kërkesës. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive nuk e ka verifikuar si e vërtetë kontratën e dhurimit.

23. Pala përgjegjëse, Ferat Hysenaj, kërkon të drejta ligjore për pronën e kërkuar duke pohuar se ai e ka blerë në mënyrë joformale pronën e kërkuar nga paraqitësi i kërkesës në vitin 2005 dhe se ai ka paguar 40,000 Euro të çmimit të pajtuar të blerjes prej 81,000 Euro. Në mbështetje të pohimit, pala përgjegjëse ka paraqitur *inter alia*

një kontratë blerje të pavërtetuar të shkruar më shkrim dore, të lidhur mes palës përgjegjëse si blerës dhe paraqitësit të kërkesës si shitës i pronës së kërkuar si edhe një listë me numrat e kartëmonedhave që pala përgjegjëse pohon se ia ka paguar paraqitësit të kërkesës në kontekstin e transaksionit. Paraqitësi i kërkesës e mohon shitjen e pronës së kërkuar tek pala përgjegjëse duke deklaruar se pala përgjegjëse e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar që nga viti 1999 dhe se ai ka marrë vetëm 200 euro nga pala përgjegjëse si qira.

24. Gjatë seancës të 32^{te} të mbajtur në dhjetor 2012, Komisioni urdhëroi mbajtjen e seancës dëgjimore për këtë kërkesë nga një prej anëtarëve të tij në bazë të nenit 5.4 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar më Ligjin nr. 03/L-079. Paraqitësi i kërkesës, pala përgjegjëse dhe dy dëshmitarët, Liman Hysenaj, i propozuar nga pala përgjegjëse dhe Miric Veselin, i propozuar nga paraqitësi i kërkesës, u ftuan të marrin pjesë në këtë seancë. Paraqitësi i kërkesës, i cili ishte ftuar sipas rregullit, nuk u paraqit e dështoi të shpjegojë mosparaqitjen e tij. Dëshmitari Miric Veselin e justifikoi mungesën me arsye shëndetësore. Pala përgjegjëse, Ferat Hysenaj dhe dëshmitari Liman Hysenaj morën pjesë në seancën e 15 janarit 2013 në mjediset e AKP-së në Prishtinë. Në seancë, pala përgjegjëse përsërit deklaratat e tij të mëparshme se ai e kishte blerë pronën e kërkuar në bazë të një kontratë informale. Dëshmitari Liman Hysenaj deklaroi se ai e kishte parë personalisht lidhjen e kontratës dhe se pala përgjegjëse kishte paguar një pjesë të çmimit të blerjes për pronën e kërkuar.

25. Komisioni konstaton se deklarata e palës përgjegjëse gjatë seancës dëgjimore është e hollësishme dhe e besueshme dhe përputhet me deklaratat e mëparshme të palës përgjegjëse në AKP si edhe me dëshmitarin Liman Hysenaj. Më tej, është dëshmi bindëse kontrata e blerjes më shkrim dore e paraqitur nga pala përgjegjëse, e cila mban dy nënshkrimet e paraqitësit të kërkesës dhe palës përgjegjëse si edhe dëshmitarëve Miric Veselin dhe Liman Hysenaj. Një tregues tjetër është se të gjitha kartëmonedhat me numrin e tyre serial i janë dhënë paraqitësit të kërkesës në përmbushjen e kontratës, janë regjistruar nga pala përgjegjëse. Komisioni vëren në anën tjetër, se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të paraqitë dëshmi në mbështetje të pretendimeve se ai ia ka lëshuar vetëm me qira pronën e kërkuar palës përgjegjëse.

26. Bazuar në sa më sipër, Komisioni konstaton se mbajtësi i së drejtës pronësore nuk e ka humbur posedimin për shkak të konfliktit të vitit 1998-1999, por si rezultat i transaksionit vullnetar të shitjes që tregon se mbajtësi i së drejtës pronësore ka pasur mundësinë të ushtrojë të drejtat pronësore. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

II. Humbje e posedimit jo për shkak të konfliktit

27. Në pesëmbëdhjetë kërkesat e identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, kërkesat janë depozituar nga paraqitësit përkatës të kërkesave në cilësinë e mbajtësit e pretenduar të së drejtës pronësore ose personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar ose sipas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore. Në të gjitha këto kërkesa, fillimisht paraqitësit e kërkesave pretenduan se ata ose familjet e tyre i kishin humbur pronat e kërkuara si rezultat i konfliktit të vitit 1998-1999.

28. Megjithatë, bazuar në lloje të ndryshme të dokumenteve të paraqitura nga paraqitësit e kërkesave ose të siguruara nga Sekretaria Ekzekutive *ex officio* ose bazuar në deklaratat e vetë paraqitësve të kërkesave, Komisioni konsideron se në të gjitha këto kërkesa, paraqitësit e kërkesave kanë dështuar të demonstrojnë se kërkesat e tyre përfshijnë rrethana që ndërlidhen drejtpërsëdrejti ose që rezultojnë nga konflikti i vitit 1998-99. Në disa nga këto kërkesa, mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore dhe familja e tyre nuk e kanë humbur kurrë posedimin e pronës së kërkuar. Rrjedhimisht të pesëmbëdhjetë kërkesa e identifikuar në pjesën A dhe B bien jashtë mandatit të Komisionit dhe duhet të hidhen poshtë.

III. Kërkesa të hedhura poshtë për mungesë të autorizimit

29. Në tre kërkesat e identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur kërkesat janë depozituar nga paraqitësi përkatës i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar ose sipas rastit, në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore ku kërkojnë konfirmimin e së drejtës pronësore për pronën e kërkuar ose riposedimin.

30. Megjithatë, paraqitësit e kërkesave nuk kanë ofruar ndonjë dëshmi se ata gëzojnë të drejta pronësore për pronat e kërkuara po ashtu Sekretaria Ekzekutive nuk ka siguruar *ex officio* dëshmi të tilla. Paraqitësit e kërkesave nuk janë anëtarë të bashkësive familjare ashtu si përcaktohet me nenin 1 dhe 5 të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, në mënyrë që të kenë mundësi për të depozituar kërkesë në emër të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Po ashtu as paraqitësit e kërkesave nuk mbajnë autorizim të vlefshëm të bërë sipas rregullit që t'i autorizojë ata të veprojnë në emër të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Rrjedhimisht këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

IV. Padi në pritje për t'u gjykuar para datës së hyrjes në fuqitë Rregullores së UNMIK-ut 2006/50

31. Kërkesa nr. 28258 e referuar në pjesën A të listës së bashkangjitur dhe kërkesa nr. 52172 e referuar në pjesën B të listës së bashkangjitur janë depozituar nga paraqitësit e kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme dokumentesh. Megjithatë, në dyja kërkesat dëshmitë janë paraqitur nga paraqitësi i kërkesës të cilat tregojnë se paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë para datës 16 tetor 2006 në gjykatën kompetente, ku kërkon konfirmimin e të drejtave pronësore për pronën e kërkuar.

32. Në bazë të nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit përjashtohet nga procedimi gjyqësor në lidhje me kërkesën e cila ka filluar para datës 16 tetor 2006, datë në të cilën ka hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50. Rrjedhimisht kërkesat nr. 28258 dhe 52172 duhet të hidhen poshtë.

33. Komisioni konstaton se të gjitha kërkesat e përfshira në këtë seksion B duhet të hidhen poshtë për arsyet e mësipërme.

C. Kërkesa të refuzuara

34. Në bazë të nenit 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 Komisioni mund të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze. Kërkesat mund të refuzohen nga Komisioni nëse paraqitësi i kërkesës, ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, nuk kanë mundur të dëshmojnë interesin për drejtat e tyre pronësore dhe të shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

35. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin nr 03/L-079, Komisioni ka kompetencë për të vendosur kërkesat e së drejtës pronësore ose të shfrytëzimit për pronën e paluajtshme. Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të marrë në konsideratë çfarëdo prova të besueshme, të cilat ai i konsideron të rëndësishme për kërkesën, përfshirë dëshmitë e paraqitura nga ana e Sekretarisë Ekzekutive lidhur me besueshmërinë e të dhënave publike. (Neni 6.2 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Komisioni mund të kërkojë nga Sekretariati për të marrë më shumë informacion nga një palë, ose për të kryer hetime shtesë në lidhje me ndonjë kërkesë (neni 6,3 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të drejtohet, por nuk është e detyruar nga rregullat e marrjes së dëshmive të aplikuara në gjykatat vendore në Kosovë (pika 6,1 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079)..

I. Mungesë e dëshmive për të drejtën pronësore.

1. Kërkesat nr. 07108 dhe 07112

36. Kërkesat nr. 07108 dhe 07112, të referuara në pjesën D të listës së bashkangjitur, janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës, Dara Kostic në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjarë të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së saj të ndjerë, Lenka Kostic. Në kërkesat nr. 36701 dhe 36702 paraqitësi i kërkesës, Zoran Kostic në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjarë të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij Bozidar Kostic, kërkon për të njëjtat pronat. Të dy paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur një kontratë blerje të verifikuar pozitivisht të vitit 1958, të lidhur me mbajtësit të së drejtës pronësore në kërkesën nr. 07108 dhe 07112, Lenka Kostic, me palën e tretë në bazë të secilës mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në kërkesat nr. 07108 dhe 07112 ka përfituar të drejtën pronësore për pronat e kërkuara. Paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 36701 dhe 36702, Zoran Bozidar Kostic, në mbështetje të këtyre kërkesave ka paraqitur vendimin e trashëgimisë të vitit 2006, sipas të cilit mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në kërkesën nr. 36701 dhe 36702, Bozidar Dragoljub Kostic, ka trashëguar pronat e kërkuara nga nëna e tij Lenka Kostic, e cila është mbajtëse e së drejtës pronësore në kërkesat nr. 07108 dhe 07112. Mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në kërkesat nr. 07108 dhe 07112 ka vdekur në vitin 1996. Vendimi trashëgimisë është verifikuar si i vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

37. Pala përgjegjëse kërkon të drejta ligjore për pronat e kërkuara duke pohuar se ai e ka blerë ato nga mbajtësi i së drejtës pronësore të kërkesave nr. 36701 dhe 36702. Në mbështetje të pohimit të tij, pala përgjegjëse ka paraqitur një kontratë blerje të lidhur me palën përgjegjëse si blerës dhe mbajtësit të pretenduar të së drejtës

pronësore në kërkesat nr. 36701 dhe 36702 si shitës të pronave të kërkuara, i cili është përfaqësuar nga një pale e tretë e autorizuar, të cilës i është dhënë autorizimi nga mbajtësi i së drejtës pronësore në kërkesat nr. 36701 dhe 36702. Kontrata e blerjes si edhe autorizimi i paraqitur nga pala përgjegjëse janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vërteta. Paraqitësi i kërkesës në kërkesën nr. 07108 dhe 07112 dhe paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 36701 dhe 36702 e mohojnë faktin se pronat e kërkuara i janë shitur palës përgjegjëse duke deklaruar se autorizimi i paraqitur është i falsifikuar. Megjithatë, ata kanë dështuar të paraqesin dëshmi në mbështetje të mbrojtjes së tyre që do të mund të kundërshtonte vlefshmërinë së kontratës së blerjes dhe autorizimit, të cilat si u theksua më sipër, janë verifikuar si të vërteta.

38. Komisioni arrin në përfundimin se, bazuar në dëshmitë para tij, mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në kërkesat nr. 07108 dhe 07112 e ka humbur pronësinë për pronat e kërkuara tek mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në kërkesat nr. 36701 dhe 36702 pas vdekjes së tij dhe me pas ne bazë të dëshmisë së trashëgimisë. Rrjedhimisht, kërkesat duhet të refuzohen.

2. Kërkesa nr. 16516

39. Kërkesa nr. 16516, e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur, është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit të pronës së kërkuar dhe riposedimin. Kërkesa është kontestuese në kuptimin se pala përgjegjëse ka shprehur interes ligjor për pronën e kërkuar dhe ka paraqitur mbrojtje në përgjigje të kërkesës. Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të ofrojë dëshmi të mjaftueshme për të provuar të drejtën e pretenduar të shfrytëzimit pasi ai ka paraqitur vetëm një vendim ndarje dhe asnjë dëshmi tjetër si kontrata e shfrytëzimit. Sipas Ligjit për Marrëdhëniet Banesore (42/86) i ndryshuar me Ligjin për Banesat (50/92), thjesht vendimi i ndarjes nuk është i mjaftueshëm për të vërtetuar të drejtën e shfrytëzimit në formën e së drejtës së banimit; e drejta e tillë lind vetëm nëse ka marrje të posedimit dhe lidhjes së kontratës së shfrytëzimit. Pasi paraqitësi i kërkesës ka dështuar të ofrojë dëshmi të mjaftueshme për të dëshmuar kërkesat përkatëse satutore për të drejtën e shfrytëzimit, kërkesa duhet të refuzohet.

3. Kërkesa nr. 00837

40. Kërkesa nr. 00837, e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur, është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit të pronës së kërkuar dhe riposedimin. Kërkesa është kontestuese në kuptimin se pala përgjegjëse ka shprehur interes ligjor për pronën e kërkuar dhe ka paraqitur mbrojtje në përgjigje të kërkesës. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kontratën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur ta verifikojë këtë dokument si të vërtetë. Paraqitësi i kërkesës dështoi të paraqitë dëshmi shtesë kur kjo iu kërkua nga Sekretaria Ekzekutive. Sekretaria Ekzekutive po ashtu nuk ka mundur të sigurojë *ex officio* dëshmi në mbështetje të kërkesës së paraqitësit të kërkesës.

41. Bazuar sa më sipër, Komisioni konstaton se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën pronësore për pronën e kërkuar. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

4. Kërkesa nr. 00960

42. Kërkesa nr. 00960 e referuar në pjesën C të listës së bashkangjitur, është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjarë të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese të verifikuar pozitivisht që e tregon një palë të tretë si pronar të pronës së kërkuar. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës deklaroi se babai i tij i ndjerë e ka blerë pronën e kërkuar nga një palë e tretë, por dështoi të paraqitë dëshmi të rëndësishme në mbështetje të këtij pretendimi. Sekretaria Ekzekutive po ashtu nuk ka mundur të sigurojë *ex officio* dëshmi që do mbështetnin kërkesën e paraqitësit të kërkesës.

43. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën pronësore për pronën e kërkuar. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

5. Kërkesat nr. 01145 dhe 01146

44. Kërkesat nr. 01145 dhe 01146 të referuara në pjesën D të listës së bashkangjitur, janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore për pronën e kërkuar dhe riposedimin. Kërkesat janë kontestuese në kuptimin se pala përgjegjëse ka shprehur interes ligjor për pronën e kërkuar dhe ka paraqitur mbrojtje në përgjigje të kërkesës. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur *inter alia* një vendim ndarje me të cilën entiteti me emrin Banka Karic pretendon t'i ketë ndarë paraqitësit të kërkesës pronat e kërkuara, një lejë me shkrim nga menaxhmenti i Bankës Karic, sipas të cilës pretendohet se paraqitësi i kërkesës është lejuar të blejë pronat e kërkuara dhe një kontratë blerje për pronat e kërkuara, sipas të cilës pretendohet se paraqitësi i kërkesës ka blerë pronat e kërkuara nga Banka Karic. Megjithatë, vetëm marrëveshja me shkrim nga menaxhmenti i Bankës Karic është verifikuar pozitivisht, ndërsa as vendimi i ndarjes dhe as kontrata e blerjes nuk janë verifikuar. Komisioni konstaton se kjo dëshmi nuk është e mjaftueshme për të dëshmuar të drejtën pronësore të mbajtësit të së drejtës pronësore.

45. Në mungesë të dëshmive të mjaftueshme në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën pronësore për pronën e kërkuar. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

6. Kërkesat nr. 01206 dhe 01209

46. Kërkesat nr. 01206 dhe 01209, të referuara në pjesën D të listës së bashkangjitur, janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit të pronës së kërkuar dhe riposedimin. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësit e kërkesës kanë paraqitur një vendim ndarje dhe një marrëveshje qiraje mbi bazën e secilës paraqitësi përkatës i kërkesës pretendon të ketë përfituar të drejtën e banimit për pronat e kërkuara respektive. Megjithatë, asnjë nga

këto dokumente nuk është verifikuar si i vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive. Sekretaria Ekzekutive po ashtu nuk ka mundur të sigurojë *ex officio* dëshmi që do mbështetnin kërkesën e paraqitësit të kërkesës.

47. Në mungesë të dëshmive të mjaftueshme në mbështetje të kërkesës, paraqitësit e kërkesës kanë dështuar të dëshmojnë të drejtën pronësore për pronën e kërkuar. Rrjedhimisht kërkesat duhet të refuzohen.

7. *Kërkesa nr. 08628*

48. Kërkesa nr. 08628, e referuar në pjesën C të listës së bashkangjitur, është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore ka të drejtën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar mbi bazën e vendimit të ndarjes dhe se mbajtësit të së drejtës pronësore i është marra prona gjatë konfliktit të vitit 1998-99. E vetmja dëshmi e paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në mbështetje të kërkesës, është një vendim i Komisionit të Lartë për Refugjatët në Serbi, që i miraton mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore të drejtën e përkohshme të strehimit në pronën e kërkuar. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur ta verifikojë këtë vendim si të vërtetë. Më tej, Komisioni konsideron se ky vendim i ndarjes që i miraton të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit të pronës së kërkuar nuk ka mundësi të krijojë të drejtën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar që ka mundësi të rikthehet sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-07. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

8. *Kërkesa nr. 10481*

49. Kërkesa nr. 10481, e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur, është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një vendim të lëshuar nga Ushtria Jugosllave, datë 12 qershor 1999. Në bazë të këtij vendimi, prona e kërkuar i është ndarë paraqitësit të kërkesës për një afat kohor të pacaktuar. Më tej, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një kontratë blerje të datës 18 qershor 1999, sipas të cilës pretendohet se paraqitësi i kërkesës ka përfutur të drejtën pronësore për pronën e kërkuar pas vendimit të lartpërmendur të ndarjes. Komisioni vëren se vendimi i ndarjes është lëshuar nga Ushtria Jugosllave pasi ka hyrë në fuqi me 10 qershor 1999, Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1. Në nenin 6, i Rregullores së UNMIK-ut 1999/1 përcakton se vetëm UNMIK-u ka të drejtë të administrojë pronën e luajtshme dhe të paluajtshme në emër të Republikës Federale të Jugosllavisë ose të Republikës së Serbisë, ose të ndonjë prej organeve të saj në territorin e Kosovës. Nga kjo rrjedh se Ushtria Jugosllave nuk ka pasur të drejtë të tjetërsojë pronën e kërkuar pas datës 10 qershor 1999 dhe rrjedhimisht vendimi i ndarjes dhe kontrata e blerjes, të dyja janë me datë mbas kësaj date, nuk përbëjnë dëshmi të së drejtës pronësore për paraqitësin e kërkesës për pronën e kërkuar.

50. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të tregojë të drejtën pronësore ose çfarëdo të drejtë tjetër për pronën e kërkuar. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

9. Kërkesa nr. 20203

51. Kërkesa nr. 20203, e referuar në pjesën C të listës së bashkangjitur, është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur *inter alia* një vendim të lëshuar nga entiteti ligjor “Kosmetska Banka AD” sipas të cilit prona e kërkuar i është ndarë paraqitësit të kërkesës dhe më pas një lejë nga Ministria e Financave të Republikës së Serbisë, sipas të cilës pretendohet t’i jetë miratuar paraqitësit të kërkesës e drejta për të blerë pronën e kërkuar. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të verifikojë asnjë nga këto dokumente. Më tej, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një kontratë blerje të lidhur mes mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore dhe entitetit ligjor “Kosovska Metohijska Banka AD” si shitës i pronës së kërkuar. Megjithatë, Komisioni vëren se kjo kontratë është vërtetuar nga një gjykatë paralele dhe rrjedhimisht nuk mund të pranohet nga Komisioni se përbën dëshmi të së drejtës pronësore. Paraqitësit të kërkesës iu kërkuar të ofrojnë dokumente të tjera për të dëshmuar të drejtën e pretenduar pronësore të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore ose vetë atij, megjithatë ai dështoi ta bëjë këtë. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

10. Kërkesa nr. 22461

52. Në kërkesën nr. 22461, e referuar në pjesën C të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një kontratë blerje të lidhur mes mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore si blerës dhe ndërmarrjes shoqërore si shitës i pronës së kërkuar. Megjithatë, pasi kjo kontratë është vërtetuar nga një gjykatë paralele, ajo nuk mund të pranohet nga Komisioni se përbën dëshmi të së drejtës pronësore. Më tej, në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur dy vendime ndarje sipas të cilëve paraqitësit të kërkesës i është ndarë e drejta e shfrytëzimit për pronën e kërkuar. Megjithatë Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të verifikojë asnjë nga këto dokumente. Komisioni konsideron se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të ofrojë dëshmi të mjaftueshme për të dëshmuar të drejtën pronësore apo të shfrytëzimit. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

11. Kërkesa nr. 25602

53. Kërkesa nr. 25602, e referuar në pjesën C të listës së bashkangjitur, është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, Ljubomir (Dusan) Mladenovic. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur *inter alia* një kontratë të përkujdesjes jetësore, sipas të cilës mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore, Ljubomir (Dusan) Mladenovic, ka përfitur pronësinë e pronës së kërkuar nga Dusan (Trajko) Mladenovic. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur ta verifikojë këtë dokument. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur dokumente të ndryshme për kërkesën e tij; megjithatë ka një mospërputhje në emrin e mbajtësit të së drejtës pronësore në dokumentet e paraqitura. Dokumentet e identifikimit e tregojnë mbajtësin e pretenduar të së drejtës pronësore si Ljubomir (Dusan) Mladenovic, ndërsa kontrata e dhurimit dhe fleta poseduese e tregojnë Ljubica (Ducana) Mladenovic si mbajtësin e së drejtës pronësore. Sekretaria

Ekzekutive e ka kontaktuar paraqitësin e kërkesës disa herë ku i ka kërkuar atij të sqarojë mospërputhjen, por ai ka dështuar të paraqitë sqarimin e kërkuar.

54. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të tregojë të drejtën pronësore ose çfarëdo të drejtë tjetër për pronën e kërkuar menjëherë para ose gjatë konfliktit të vitit 1998-99. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

12. Kërkesa nr. 26828

55. Kërkesa nr. 26828, e referuar në pjesën C të listës së bashkangjitur, është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar dhe riposedimin. E vetmja dëshmi e paraqitur nga paraqitësi i kërkesës, në mbështetje të kërkesës, është vendimi i ndarjes që pretendohet se i miraton mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore të drejtën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur ta verifikojë këtë dokument. Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të paraqitë dëshmi shtesë kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

13. Kërkesa nr. 33137

56. Kërkesa nr. 33137, e referuar në pjesën D të listës së bashkangjitur, është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin. Kërkesa është kontestuese në kuptimin se pala përgjegjëse ka shprehur interes ligjor në pronat e kërkuara dhe ka paraqitur mbrojtje në përgjigje të kërkesës. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës, ka paraqitur *inter alia* një vendim të ndarjes dhe kontratën e blerjes të vitit 1998. Megjithatë, asnjë nga dokumentet nuk është verifikuar si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive. Sekretaria Ekzekutive po ashtu nuk ka mundur të sigurojë *ex officio* dëshmi që do mbështetnin kërkesën e paraqitësit të kërkesës. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka kërkuar përkthimin e dokumenteve pa pagesë të cilat janë paraqitur nga pala përgjegjëse në përgjigje të kërkesës, por se Sekretaria Ekzekutive e ka refuzuar këtë kërkesë pasi paraqitësi i kërkesës nuk ka përmbushur kërkesat e duhura. Komisioni i shqyrtoi këto dokumente dhe konsideron se këto dokumente nuk kanë ndikim në rezultatin e këtij vendimi.

57. Bazuar në dëshmitë para tij, paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën pronësore për pronën e kërkuar. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

14. Kërkesa nr. 34274

58. Kërkesa. 34274, e referuar në pjesën C të listës së bashkangjitur, është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore të pronës së kërkuar (banesë). Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një vendim ndarje të verifikuar pozitivisht të vitit 1992, sipas të cilit paraqitësi i kërkesës është lejuar të marrë me qira pronën e kërkuar për 10 vjet deri në shkurt 2002, një marrëveshje qiraje të verifikuar pozitivisht për pronën e kërkuar e lidhur me paraqitësit të kërkesës dhe Republikën Federale të Jugosllavisë në nëntor 2002 si edhe një kontratë blerje po ashtu e lidhur me Republikën Federale të

Jugosllavisë si shitës dhe paraqitësin e kërkesës si blerës i pronës së kërkuar bazuar në vendimin e lartpërmendur të ndarjes. Kontrata e blerjes është verifikuar po ashtu si e vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

59. Komisioni konsideron se, mbi bazën e vendimit të ndarjes të vitit 1992, paraqitësit të kërkesës i është miratuar vetëm e drejta e qiramarrjes të pronës së kërkuar për një afat kohor të kufizuar, i cili ka skaduar në nëntor 2002. Komisioni konsideron se vendimi i ndarjes që miraton thjesht të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit nuk krijon të drejtën e shfrytëzimit të pronës së kërkuar ashtu si përcaktohet me nenin 2 të Ligjit për Marrëdhëniet Banesore dhe nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07. Rrjedhimisht, në kohën e lidhjes së kontratës së blerjes, paraqitësi i kërkesës nuk ka pasur të drejtë të përfitojë pronësinë për pronën e kërkuar, pasi neni 16 i Ligjit për Marrëdhëniet Banesore ua mundëson vetëm mbajtëseve të ligjshëm të së drejtës se shfrytëzimit përfitim të pronësisë për banesën. Më tej, Komisioni vëren se në kohën e lidhjes së kontratës së blerjes në vitin 2002, Republika Federale e Jugosllavisë e kishte humbur të drejtën për të tjetërsuar pronën e kërkuar. Sipas nenit 6 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/1, vetëm UNMIK-u ka pasur të drejtë të administrojë pronën e luajtshme dhe të paluajtshme të regjistruar në emër të Republikës Federale të Jugosllavisë ose të Republikës së Serbisë, ose të ndonjë prej organeve të saj në territorin e Kosovës. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1 ka hyre në fuqi më 10 qershor 1999. Rrjedhimisht kontrata e blerjes e pas kësaj date, nuk përbën dëshmi të së drejtës pronësore për paraqitësin e kërkesës për pronën e kërkuar.

60. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të tregojë të drejtën pronësore ose çfarëdo të drejtë tjetër për pronën e kërkuar. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

15. Kërkesa nr. 36563

61. Kërkesa nr. 36563, e referuar në pjesën C të listës së bashkangjitur, është depozituar nga paraqitësi i kërkesës përmes personit fizik të autorizuar në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një fletë poseduese që e tregon mbajtësin e pretenduar të së drejtës pronësore si pronar të pronës së kërkuar. Megjithatë, në kërkesën nr. 31303 që lidhet me të njëjtën pronë, Sekretaria Ekzekutive ka siguruar një certifikatë të përditësuar të të drejtave të pronës së paluajtshme që e tregon një palë të tretë si pronare të ligjshëm. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se prona e kërkuar është tani në pronësi të një pale të tretë, në bazë të kontratës së dhurimit të lidhur me mbajtësin e pretenduar të së drejtës pronësore.

62. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të tregojë të drejtën pronësore ose çfarëdo të drejtë tjetër për pronën e kërkuar në favor të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

II. Tjetërsimi vullnetar para konfliktit

63. Në dhjetë kërkesat e referuara në pjesët C dhe D të listës së bashkangjitur, kërkesat janë depozituar nga paraqitësit e kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore personalisht ose përmes personit fizik të autorizuar

ose sipas rastit në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtesit të së drejtës pronësore. Në te gjitha këto kërkesa paraqitësit e kërkesave pretenduan fillimisht se ata ose familjet e tyre i kanë humbur pronat e kërkuara për shkak të konfliktit 1998-99. Megjithatë, më pas, paraqitësit e kërkesave e informuan Sekretarinë Ekzekutive se ata ose familjet e tyre i kanë tjetërsuar vullnetarisht pronat e kërkuara para konfliktit të vitit 1998-1999.

64. Në këto rrethana, pasi paraqitësit e kërkesave kanë pranuar se nuk kanë pasur të drejta pronësore ose çfarëdo të drejtë tjetër pronësore menjëherë para ose gjatë konfliktit të 1998-99, kërkesat duhet të refuzohen.

D. Kërkesa për kompensim

65. Në kërkesat nr. 07108, 07112, 10139, 31711 dhe 31719 paraqitësi i kërkesës përveç pronësisë kërkon gjithashtu kompensimin për demin fizik të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla. Rrjedhimisht këto kërkesa për kompensim hidhen poshtë.

E. Vërejtje përmbledhëse

66. Nisur sa më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e shënuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur duhet të hidhen poshtë dhe kërkesat e shënuar në pjesët B dhe kërkesat e shënuara në pjesët C dhe D të listës së bashkangjitur duhet të refuzohen dhe udhëzon të nxirret një urdhër në lidhje me secilin kërkesë ashtu si është përcaktuar më sipër.

67. Vendimet dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rast, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar banesore.

68. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Gjykata Supreme e Kosovës mund të vjelë tarifën e gjyqësore për procedurën e ankesës.

Informacione lidhur me procedurën e ankesave gjenden në fletën informuese për ankesën e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA01117	KPA26001	KPA30531	KPA30532	KPA52187	KPA53034	KPA53115
KPA00622	KPA00809	KPA00810	KPA01110	KPA11595	KPA11686	KPA11718
KPA92440	KPA21168	KPA53958	KPA54033 REP	KPA13586 REP	KPA28258	KPA44823

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA31711	KPA36701	KPA36702	KPA44998	KPA50001	KPA52172	KPA54909
KPA00903	KPA18176	KPA23384	KPA51050	KPA51051	KPA00791	KPA01039

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA10481	KPA34274	KPA08628	KPA51622	KPA20203	KPA24461	KPA26828
KPA00960	KPA36563	KPA25602				

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part D/Pjesa D/Deo D

KPA00966	KPA01209	KPA07108	KPA07112	KPA31719	KPA33137	KPA91499
KPA01145	KPA01146	KPA01206	KPA34292 REP	KPA51557 REP	KPA92773	KPA92774
KPA92775	KPA92776	KPA16516	KPA00837			